

Njoftim për pjesëmarrjen në konkurimin publik për qeradhënien e sipërfaqeve (shesh) prej 1 500 m², 2 000 m² dhe 2 000 m² me qëllim depozitimin e mineraleve në portin e Durrësit.

Në zbatim të VKM nr. 529 datë 08.06.2011, “Për përcaktimin e kriterëve , të Procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” Autoriteti Portual Durrës, shpall konkurimin për dhënien me qera të objektit “Sipërfaqe 1 500 m², 2 000 m² dhe 2 000 m²” në territorin e Autoritetit Portual Durrës.

Të dhëna për objektin dhe përdorimin

Përshkrimi i sheshit : Sheshe të destinuar për depozitimin e mineraleve sipas Hartës së Administrimit të Territorit të APD-së.

Vendndodhja: Sheshet e destinuar ndodhen në pjesën lindore të portit, sipas gent planit publikuar në faqen e internetit www.apdurrës.com.al.

Sipërfaqja : Sipërfaqja e këtyre tre shesheve është përkatësisht 1 500 m², 2 000 m² dhe 2 000 m²

Afati i qeradhënies është 1 vit.

Veprimtaria që ushtrohet në objekt: Destinacioni i përdorimit të këtyre shesheve është depozitimi i mineraleve. Mallrat që do të depozitohen nga qeramarrësi duhet të jenë mallra që janë të destinuar për transport me anije.

Qeramarrësi duhet të përmbushë kërkesat përkatëse të legjislacionit Shqiptar dhe të Ligjit dhe rregullat për Autoritetin Portual Durrës, si dhe të jetë në përputhje me rregullat dhe ligjet për respektimin e sigurisë (safety and security) dhe mbrojtjen e mjedisit.

Qeramarrësit nuk i lejohet të kryejë apo të performojë asnjë aktivitet përpunimi përfshirë këtu edhe aktivitetet operacionale. Termi operacional përfshin gjithashtu edhe ngarkimin apo shkarkimin nga mjetet e transportit, trailerat, vagonat e trenave, nga konteinerët ose të njësive të ngjashme (mbushjen apo zbrazjen e tyre).

Qeramarrësi nuk duhet të kryej asnjë manipulim me mallrat në shesh pa marrë më parë aprovimin me shkrim nga APD. Termi manipulim përfshin aktivitete si grumbullimi apo shpërndarja, pastrime, riparime etj.

Cmimi dysheme i qerasë

Vlera dysheme e qerasë është **2 lek/ m²/ditë**.

Kriteret e vlerësimit:

Vlera e qerasë 100 pikë.

Afati i dorëzimit te ofertave në datën 25.01.2012, ora 10:00 në sallën e Mbledhjeve të Autoritetit Portual Durrës.

Ofertat do te hapen më datë 25.01.2012 ora 10:00 në sallën e Mbledhjeve të Autoritetit Portual në prani të komisionit të shqyrtimit të ofertave dhe subjekteve konkurruese.

Dokumentacioni që duhet të dorëzojnë subjektet konkurruese:

Kërkesën e subjektit për marrjen me qira te objektit ;

b) Planbiznesin, ku te jepet me hollësi vënia në funksionim të shesheve ku bëjnë pjesë:

Plani i depozitimit të mallrave gjatë kohëzgjatjes së kontratës, tonazhin, llojet dhe sasi të mallrave që parashikojnë të depozitohen, kontrata paraprake për depozitim;

c) Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;


c)Çertifikatën e regjistrimit dhe çertifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR;

d) NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;

dh)Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me veprimtarinë;

e) Sigurim oferte në vlerën e qirasë së një muaji,të shpallur në njoftimin për konkurrim;

Për informacione të mëtejshme, Ju lutemi të kontaktoni në Drejtorinë Ekzekutive të Autoritetit Portual, Nr tel/ fax 052 223115 dhe faqen e internetit www.apdurrës.com.al


Ing. Eduard NDREU
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

